




BASHKIA FIER

MIRATOI

ZV/KRYETAR: SUELA PRIFTI

**PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025-2030**



Diaspora Shqiptare në botë (2020)



Implemented by

giz

Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Fjalë nga Kryetari i Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi

“...Të dashur qytetarë të Fierit,



Është kënaqësi dhe privilegj për mua si kryetar i Bashkisë Fier që sot prezantojmë Planin Lokal të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030. Ky plan është një dëshmi e angazhimit tonë të përbashkët për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit

tonë, duke vlerësuar dhe fuqizuar lidhjet me ata që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, por që mbajnë zemrën gjithmonë të lidhur me Fierin. E dimë se migracioni ka ndikuar thellë në shumë familje dhe komunitete. Për këtë arsye, ky plan është krijuar për të zhvilluar politika që mbështesin integrimin e të rikthyerve, promovojnë mundësitë e investimit dhe bashkëpunimit nga diaspora, dhe që ruajnë vlerat tona kulturore. Gjithashtu, ky është një moment për të treguar që diaspora nuk është vetëm një burim ekonomik, por një forcë intelektuale dhe sociale që mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit tonë.

Duke punuar së bashku, besojmë se do të arrijmë të krijojmë më shumë mundësi për të rinjtë dhe të sigurojmë që bashkëqytetarët tanë, kudo që ndodhen, të jenë pjesë aktive e zhvillimit të Fierit. Faleminderit për mbështetjen tuaj, dhe le të vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë...”



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030

BASHKIA FIER

Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030 me mbështetjen e Programit “Formimi i Migrimit të Orientuar drejt Zhvillimit”, i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ-Shqipëri.

Në procesin e hartimit dhe konsultimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën u anagzhua grupi i punës si më poshtë,

Grupi i punës

- | | |
|------------------|-----------------------|
| 1. Sibora Kadriu | Bashkia Fier |
| 2. Selnada Tyto | Bashkia Fier |
| 3. | Bashkia Fier |
| 4. Valmira Guzi | Ekspert – Key Adviser |
| 5. Arbi Basho | Ekspert – Key Adviser |
| 6. Mariel Hysa | Ekspert – Key Adviser |

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	I
LISTA E TABELAVE.....	II
HYRJE	1
METODOLOGJIA.....	2
KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR	5
PLANET VENDORE TË BASHKISË FIER	12
PROFILI I BASHKISË FIER	15
PERSPEKTIVA GJINORE	18
ANALIZA PESTEL.....	20
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR FIER	27
FUSHA E VEPRIMIT A	28
FUSHA E VEPRIMIT B.....	33
FUSHA E VEPRIMIT C.....	36
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT	39
FORMATET E RAPORTIMIT	49

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BF	Bashkia Fier
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBD	Dhoma e Biznesit të Diasporës
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GCM	Kompakti Global për Migracionin

GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MB	Ministria e Brendshme
MPV	Ministri për Pushtetin Vendor
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Analiza PESTEL	20
Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Fier	27
Tabela 3: Fusha e Veprimit A	31
Tabela 4: Fusha e Veprimit B	34
Tabela 5: Fusha e Veprimit C	37
Tabela 6: Monitorimi i Planit të Veprimit.....	40
Tabela 7: Formati i Raportimit të Planit të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, Bashkia Fier	50

HYRJE

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën në bashkinë Fier u realizua në kuadër të Programit të GIZ (MEG) **“Fuqizimi i Politikave për Orientimin e Migracionit drejt Zhvillimit”** i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane. Ky plan është bazuar në ligjin kombëtar dhe lokal, si dhe në udhëzimet për planifikimin e territorit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimet në ligjin për vetëqeverisjen vendore në vitin 2015 dhe në vitin 2019, adresojnë nevojën për hartimin e këtij plani, duke e bërë atë një element shtesë për qeverisjen e bashkive, duke përfshirë migracionin dhe diasporën në procesin e planifikimit, veprimit dhe monitorimit të projekteve dhe planeve që lidhen me ta. Ndër të tjera, këto ndryshime kanë përcaktuar dhe shtuar detyrat dhe funksionet e bashkive në lidhje me diasporën dhe migracionin, duke shtuar përgjegjësitë e tyre për këto çështje të nivelit lokal:

1. Krijimi i një strukture të specializuar për menaxhimin e shërbimeve të diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pjesë e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
2. Inkurajimi i organizatave brenda dhe jashtë vendit për të ruajtur komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
3. Ofrimi i ndihmës dhe informacionit për procesin e fitimit të shtetësisë shqiptare;
4. Furnizimi me ndihmë dhe informacion për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni rreth legjislacionit shqiptar për investimet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për investimet;
5. Koordinimi me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, të jashtme dhe për diasporën për sigurimin e ndihmës dhe informacionit për çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin.

Nëpërmjet këtyre masave dhe politikave, synohet të krijohen struktura funksionale dhe politika të përshtatshme për menaxhimin e migracionit dhe statusit të diasporës shqiptare në botë, duke thelluar ndërveprimin e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Kjo orienton dhe përfshirjen e diasporës në procesin e planifikimit të nivelit lokal dhe hartimin e një manuali me objektiva dhe masa strategjike për këtë qëllim, duke përcaktuar rolin e aktorëve të interesuar në fushën e migracionit dhe diasporës.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në procesin e hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën siguron bashkëpunimin me ministritë, agjencitë dhe njësitë e qeverisjes vendore duke nxitur pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të dinamikës së migracionit dhe procesit të planifikimit. Qasja metodologjike dhe arritja e objektivave efektiv për adresimin dhe shfrytëzimin e sfidave të migracionit dhe mundësitë në nivel lokal, kanë kaluar në disa faza:

Analizimi dhe vlerësimi i nevojave dhe potencialit të komunitetit për evidentimin e sfidave dhe përcaktimin e mundësive për diasporën dhe migracionin, si dhe identifikimi i nevojave reale të bashkisë nëpërmjet:

- ⇒ Mbledhja e të dhënave të disponueshme nga burime të ndryshme, si nga sportelet e migracionit pranë Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Aftësive, pranë institucioneve publike respektive, vizitave në terren, intervistave dhe konsultimeve me banorët, migrantë të rikthyer dhe diasporë, që do të shërbejnë me vonë për identifikimin e nevojave.
- ⇒ Përmbledhje e dokumenteve dhe politikave në nivel vendor dhe kombëtar, duke identifikuar tendencat dhe qëndrimet aktuale për migracionin. Ky proces përfshin shqyrtimin e dokumenteve për të kuptuar sfidat dhe qasjet aktuale, si dhe harmoninë e politikave të vendit me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.
- ⇒ Analiza e praktikave më të mira. Shqyrtim i shembujve ndërkombëtarë dhe kombëtarë për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve, me fokus në përvojën e vendeve të ngjashme dhe rajonit si një model krahasues për të përmirësuar qasjen në Shqipëri.

Angazhimi i aktorëve vendorë dhe Diasporës në një proces konsultativ për Hartimin e Planit të Veprimit.

Organizim i tryezave të rrumbullakëta dhe takimeve të posaçme me përfaqësues të bashkisë, komunitetit, bizneseve lokale dhe anëtarëve të diasporës, me qëllim diskutimin dhe identifikimin e nevojave, mundësive dhe strategjive të përbashkëta.

Zhvillim dhe përforsim i kanaleve të posaçme të komunikimit për të lehtësuar përfshirjen aktive të diasporës në projektet zhvillimore të Fierit. Këto kanale do të shërbejnë si ura lidhëse për nxitjen e investimeve, ndarjen e përvojave dhe ekspertizës, si dhe për të mbështetur ndërveprimin e vazhdueshëm midis diasporës dhe komunitetit lokal.

Studimi i kuadrit strategjik, ligjor dhe institucional në nivel, ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor për Migracionin dhe Diasporën.

Kjo fazë siguron që plani të jetë në harmoni me legjislacionin dhe strategjitë në fuqi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të fokusuar te migracioni dhe diaspora, nëpërmjet:

Shqyrtimit të politikave aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përshtatshmëinë e tyre në nivel lokal për të siguruar një qasje të qëndrueshme dhe koherente.

Analiza e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga kuadri ekzistues dhe integrimi i këtyre elementeve në politikat lokale, duke siguruar kështu përputhshmëri dhe harmonizim me kërkesat ligjore.

Përcaktimi i Objektivave të qarta dhe të matshme për rezultate të prekshme në zhvillimin e Bashkisë.

Sigurimi i ndikimit të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në zhvillimin e bashkisë, me një fokus të veçantë te kthimi i migrantëve, përfshirja e diasporës dhe forcimi i kapaciteteve lokale. Ky proces përfshin:

Kornizim i objektivave kryesore: Krijimi i objektivave specifike për nxitjen e kthimit të migrantëve dhe riintegrimin e tyre, përfshirjen e diasporës në projektet dhe investimet lokale, si dhe përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve të strukturave vendore për të menaxhuar në mënyrë efektive zhvillimin.

Zhvillimi i masave konkrete: Hartimi i një plani të detajuar veprimi që përfshin masa të qarta, afate kohore dhe përgjegjësi të ndara. Ky plan do të përcaktojë hapat konkretë për zbatimin e objektivave, duke angazhuar aktorë lokalë dhe kombëtarë, si dhe përfaqësues të diasporës. Në mënyrë që të jetë i matshëm dhe i kontrollueshëm përmes treguesve specifikë të performancës, duke siguruar kështu monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të progresit të arritur.

Ndërmarrja e iniciativave për rritjen e kapaciteteve të stafëve lokale dhe grupeve të punës për pjesmarrje aktive dhe zbatim efektiv të planit të veprimit.

Organizimi i sesioneve të strukturuar trajnimi për pajisjen e zyrtarëve me njohuri dhe aftësi praktike për të përmbushur rolet e tyre në mënyrë efektive dhe për të përballuar sfidat në lidhje me migracionin, përfshirja e diasporës, dhe zhvillimi ekonomik.

Involvimi i grupeve të punës për ndjekjen dhe drejtimin e zbatimit të planit, të përbëra nga përfaqësues të bashkisë dhe aktorë të tjerë lokalë. Mbështetje, koordinim dhe përmirësimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe diasporën, duke siguruar që procesi të monitorohet në çdo

fazë dhe të reagojë ndaj ndryshimeve në kohë reale.

Metodat e Përdorura

Formimi i një grupi pune për hartimin dhe konsultimin e planit, me specialistë të migracionit dhe diasporës, ekspertë të çështjeve juridike, si dhe specialistë të kostimit dhe buxhetit të bashkisë, dhe sektore social e kulturor. Ky grup synon të sigurojë që plani të përmbajë një strukturë të qëndrueshme, të përshtatur për nevojat dhe prioritetet specifike të Bashkisë dhe komunitetit.

Organizimi i Fokus Grupeve të cilat zhvilluan diskutime për të mbledhur informacione të drejtpërdrejta nga institucionet publike lokale. Këto grupe ndihmojnë në dakordësimin e fushave kryesore të veprimit, objektivave dhe masave konkrete që duhet të parashikohen në plan.

Dialogu Shumë-Palësh i organizuar nga Key Adviser dhe GIZ (MEG) u fokusua në mbështetjen e Bashkive për zhvillimin e Planeve Lokale të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën. Përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, Bashkitë, AKPA, dhe sektori privat ishin të pranishëm në këtë aktivitet shumëdimensional. Key Adviser mbështeti konkretisht Bashkinë Fier në këtë proces për hapat e parë në hartimin e planit lokal të migracionit dhe diasporës.

Workshop dhe Trajnime: Objekti kryesor i këtyre workshop-ve ishte shqyrtimi dhe përmirësimi i draft planeve për Bashkinë Fier, me fokus në forcimin e masave konkrete sipas kontekstit lokal për angazhimin e migracionit dhe diasporës si dhe për të rritur bashkëpunimin mes ekipit të ekspertëve dhe grupit të punës.

Po ashtu organizimi i sesioneve të trajnimit për përfaqësuesit lokalë të Bashkisë Fier ka si qëllim përmirësimin e aftësive, rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre në lidhje me hartimin dhe zbatimin efektiv të objektivave të planifikuara. Këto aktivitete janë të domosdoshme për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Konsultimi me Bashki të tjera pilot, si Shkodra, Kukësi, Dibra, Elbasani dhe Korça, që kanë përvojë në hartimin dhe zbatimin e Planeve Vendore për migracionin dhe diasporën, për të shkëmbyer praktika dhe përvojat më të mira.

Konsultimi Publik i Planit: Në përfundim, plani do të kalojë përmes një procesi të konsultimit publik, duke siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut dhe palëve të tjera të interesuara

në hartimin dhe finalizimin e Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën.

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Në spektrin ndërkombëtar Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në fushën e migracionit duke adoptuar Marrëveshjen Globale për Migracionin (GCM) në dhjetor 2018, gjatë Konventës Ndërqeveritare në Marrakesh, e cila synon të lehtësojë lëvizjen e sigurt të migrantëve dhe të maksimizojë përfitimet që ata sjellin. Qeveria shqiptare ka integruar GCM-në në politikat e saj të migracionit dhe ka dorëzuar një raport vlerësimi për periudhën 2019-2021, po ashtu ka hartuar raporte për rishikimin rajonal dhe kombëtar të GCM-së në vitet 2020 dhe 2022, duke e vlerësuar anëtarësimin në Bashkimin Evropian si një prioritet kyç për zhvillimin e vendit. Përmes Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Planit të Veprimit 2024-2030, Shqipëria synon të përmirësojë koherencën ndërmjet politikave dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, shtuar faktin që Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ofron udhëzime të vazhdueshme për zbatimin e GCM-së, duke nënvizuar lidhjen me SKM-në. Në këtë kontekst, një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet promovimi i kthimit vullnetar të migrantëve, që konsiderohet një mënyrë efektive për të parandaluar migrimin e të kualifikuarve. Kthimi dhe riintegrimi i të miturve të pashoqëruar dhe të kthyer në rrethana të cenueshme janë gjithashtu detyra të rëndësishme, me qëllim për të parandaluar keqpërdorimin e regjimit pa viza dhe për të ulur kërkesat për azil në Bashkimin Evropian, janë të nevojshme masa urgjente dhe konkrete. Një prioritet tjetër është përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e flukseve të migracionit, duke krijuar hapësira adekuate për të miturit, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikimit.

Ministria e Brendshme, përmes Departamentit të Antitrafikimit dhe Migracionit, është e angazhuar për të informuar vazhdimisht institucionet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm. Për të përmirësuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2024-2030), është e rëndësishme që të krijohen mekanizma efektivë për konsultime të rregullta me palët e interesuara. Këto konsultime do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe sfidave që hasin ata që kërkojnë strehim dhe mbështetje, duke u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në procesin e vendimmarrjes.

Duke u mbështetur në parimet e Kompaktit Global për Refugjatët, Shqipëria duhet të angazhohet për të forcuar bashkëpunimin me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, për të siguruar një ndarje të drejtë të barrës dhe përgjegjësisë në trajtimin e krizave të migracionit. Iniciativat për rritjen e kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe përmirësimin

e kushteve të jetesës për refugjatët dhe migrantët do të jenë thelbësore. Kjo do të përfshijë trajnimet për punonjësit e shërbimeve sociale, ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe sociale, si dhe integrimin e refugjatëve në komunitetet lokale. Angazhimi i Shqipërisë në Forumin e Parë Global të Refugjatëve në 2019, dhe përfshirja e vazhdueshme për të adresuar sfidat e migracionit, tregon se vendi është në rrugën e duhur për të ndihmuar ata që janë në nevojë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me një qasje të koordinuar dhe proaktive, Shqipëria mund të shërbejë si një model në menaxhimin e migracionit dhe mbështetje të refugjatëve në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Në përgjigje të kësaj në shkurt të 2021, qeveria shqiptare miratoi një ligj të ri për azilin, i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të sistemit të azilit me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Ky ligj parashikon zhvillimin e një mekanizmi nga Ministria e Brendshme për vlerësimin e proceseve të azilit dhe përmirësimin e cilësisë së procedurave, duke bashkëpunuar ngushtë me UNHCR. Një aspekt kyç i këtij procesi është organizimi i trajnimeve për zyrtarët e azilit në bashkëpunim me EUAA, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit në trajtimin e kërkesave për azil. Për më tepër, strategjia e Bashkimit Evropian për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin, e publikuar në prill 2021, thekson rëndësinë e krijimit të një sistemi të përbashkët për menaxhimin e kthimeve dhe riintegrimi vullnetar të migrantëve. Kjo strategji fokusohet në forcimin e shërbimeve publike në vendet e origjinës, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për punësim, duke e bërë riintegrimin më të suksesshëm. Bashkëpunimi ndërkombëtar, angazhimi i shoqërisë civile dhe përfshirja e sektorit privat janë thelbësore për arritjen e këtyre objektivave.

Agjencia Frontex po ashtu është angazhuar të mbështesë këtë proces, duke dërguar oficerë ndërlidhës në vendet e treta për të organizuar ripranimin e migrantëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve vendore. Qeveria shqiptare ka shprehur angazhimin e saj për të harmonizuar politikat kombëtare me ato të BE-së përmes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030. Kjo strategji përfshin prioritetet për migracionin që përputhen me paktin e BE-së, me një fokus të veçantë në tërheqjen e migrantëve shqiptarë dhe lehtësimin e riintegrit të tyre.

Gjatë Samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, u diskutua gjithashtu për Planin e Veprimit të BE-së, i cili përmban 20 masa operationale për forcimin e menaxhimit të kufijve, procedurat e shpejta të azilit dhe luftimin e kontrabandës së migrantëve. Qeveria shqiptare ka integruar këto masa në Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2024-2030, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e migracionit të sigurt dhe të rregullt. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2023 konfirmon se kuadri

ligjor për migracionin është gjerësisht në përputhje me *acquis* të BE-së, duke dëshmuar angazhimin e vendit për të përmirësuar sistemin e tij të menaxhimit të migracionit dhe për të siguruar një mbështetje efektive për ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në Bashkimin Evropian dhe ofrojnë një perspektivë më të mirë për migrantët dhe ata që kërkojnë azil. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE-së për zbatimin e Planit të Veprimit për Ballkanin Perëndimor ka sjellë rezultate të dukshme. Shqipëria ka finalizuar një Marrëveshje të rishikuar me Frontex-in, duke përafruar 26 nga 29 aktet legjislative të nevojshme. Megjithatë, sfidat mbeten, sidomos në lidhje me kthimin e shtetasve të vendeve të treta, që është ende në nivele të ulëta.

Policia e Kufirit dhe Migracionit ka nevojë të krijojë struktura trajnuese për identifikimin e grupeve vulnerabël dhe të forcojë koordinimin me departamentet e antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijëve. Në fushën e azilit, Shqipëria ka përafruar 15 akte legjislative, por konsultimet me EUAA vazhdojnë të mbeten thelbësore për përmirësimin e procesit. Rritja e kërkesave për azil nga shqiptarët në vendet e BE-së tregon nevojën për masa ri-integrimi, veçanërisht për ata që janë më në nevojë. Raporti gjithashtu evidenton progresin në lirinë e lëvizjes, me një rënie të refuzimeve në pikat kufitare.

Në aspektin e *kydrut kombëtar* ka një gamë dokumentash strategjike që përputhen dhe përkojnë më masat dhe objektivat e planit të veprimit si, **Strategjia Kombëtare e Diasporës** dhe Plani i Veprimit 2021-2025 që janë korniza strategjike për mbështetje ndaj shqiptarëve jashtë atdheut. Qëllimi kryesor është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse për komunitetet shqiptare, duke siguruar angazhim dhe mbështetje ligjore. Strategjia promovon integrimin dhe kontributin e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë. Ajo synon të fuqizojë lidhjet mes shqiptarëve në mbarë botën dhe të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe vendit. Plani i veprimit përforcon politikën lokale për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm.

Një tjetër dokument që përkon me objektivat dhe masat e planit të veprimit është *Strategjia Kombëtare e Migracionit* dhe Plani i Veprimit 2024-2030 synojnë të koordinojnë aktivitetet e institucioneve për të arritur objektivat e politikave migratore. Fokusohen në zhvillimin e politikave efektive që promovojnë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik. Dokumenti përfshin masa për lehtësimin e procedurave për leje unike, shërbime integrimi dhe riintegrim të emigrantëve. Rëndësi i jepet krijimit të mekanizmave koordinues në të gjitha nivelet e qeverisjes, sidomos në nivelin lokal.

Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve nga migracioni dhe ndikimin e qëndrueshëm në ekonomi, sakaq **Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030** në Shqipëri adreson sfidat e punësimit përmes pesë qëllimeve kryesore si: reduktimi i mospërputhjeve të aftësive, rritja e niveleve të aftësive për të dyja gjinitë, përmirësimi i vlerave të punës, dixhitalizimi i mbështetjes për punësim dhe sigurimi i funksionimit të saktë dhe në kohë të masave. Ajo gjithashtu fokusohet në integrimin social dhe territorial, duke adresuar sfidat e migracionit dhe diasporës me një qasje të personalizuar. Kjo strategji ofron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi në Shqipëri.

Një dokument tjetër që korespondon me qëllimet dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027** që thekson rëndësinë e diasporës shqiptare për rritjen ekonomike të vendit. Ajo nxit angazhimin e diasporës në aktivitete ekonomike dhe promovon nisma sipërmarrëse, duke krijuar një kuadër ligjor që lehtëson investimet. Qëllimi është forcimi i lidhjeve brenda komunitetit shqiptar dhe shfrytëzimi i potencialit të diasporës si burim për zhvillimin ekonomik. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon krijimin e një ambienti miqësor për bashkëpunim dhe përmbushjen e nevojave lokale për investime nga diaspora.

Arsimi në Republikën e Shqipërisë menaxhohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas **Strategjisë Kombëtare për Arsimin** dhe Planit të Veprimit 2021-2026. Këto dokumente adresojnë sfidat e arsimit duke përcaktuar përgjegjësitë midis Ministrisë së Arsimit dhe njësive lokale të vetëqeverisjes vendore. Ato kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, veçanërisht në sistemin e arsimit parashkollor. Strategjia thekson mbështetje për fëmijët në rrezik, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe minoritetet. Po ashtu, në kuadër të planit për Migracionin dhe Diasporën, fokusohet në ofrimin e informacionit dhe mbështetje për rikthyerit dhe të huajt, për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri. Një tjetër shërbim thelbësor që ofrohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore është shërbimi shëndetësor.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 synon të sigurojë zbatimin efektiv të nismave shëndetësore në nivel kombëtar përmes një bashkëpunimi të ngushtë me aktorë të ndryshëm, si ministrinë dhe përfaqësuesit vendor. Kjo strategji ofron një kornizë të qartë për koordinimin dhe mbështetje për ata që përballen me sfida të veçanta, siç janë ata që rikthehen nga emigracioni dhe të huajt. Ajo garanton akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor në nivel lokal, duke siguruar që çdo individ të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet e nevojshme.

Në këtë mënyrë, strategjia kontribuon në një mirëqenie më të plotë të popullsisë, duke adresuar nevojat unike të grupeve të ndryshme dhe duke krijuar një sistem shëndetësor më të integruar dhe të aksesueshëm për të gjithë përfshirë të huajt që jetojnë në Shqipëri.

Ndërkohe një aspekt tjetër më largpamës thekson rëndësinë që ka **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030** në Shqipëri paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila ndërtohet mbi sukseset e strategjisë së mëparshme (2015-2020). Ajo fokusohet në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratave për anëtarësim në Bashkimin European. Kjo strategji angazhon institucione të ndryshme, duke siguruar një koordinim të efektshëm në procesin e zhvillimit dhe integritit të vendit. Gjithashtu, Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon të krijojë një sistem të fuqishëm qeverisjeje për menaxhimin e migracionit, duke adresuar sfidat përkatëse dhe duke theksuar rëndësinë e tij për zhvillimin kombëtar.

Pa dyshim, që rinia është e ardhmja e çdo kombi, dhe **Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029** synon të fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, duke i inkurajuar ata të angazhohen aktivisht në shoqëri dhe në proceset vendimmarrëse. Kjo strategji përfshin politika të informuara dhe të mirëfinancuara, të cilat promovojnë mundësi arsimore dhe zhvillimin e aftësive në një kontekst global. Një fokus i veçantë i saj është adresimi i nevojave të grupeve vulnerabël, si studentët e huaj dhe ata që janë kthyer nga emigracioni. Qëllimi është të krijohet një kuadër gjithëpërfshirës që siguron zhvillimin dhe mirëqenien e të rinjve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive dhe integrimin në tregun e punës. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të qëndrueshme, ku çdo i ri ndjen se ka një rol të rëndësishëm në formësimin e të ardhmes së vendit të tij.

Një rëndësi të padiskutueshme ka **Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030** e cila paraqet një bazë të fortë për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve duke theksuar rëndësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore në sigurimin e qeverisjes së mirë, duke përmirësuar shërbimet për komunitetet. Reforma administrative ka sjellë decentralizim të funksioneve, duke i lejuar bashkive të operojnë në mënyrë demokratike dhe të adresojnë nevojat specifike të komuniteteve të tyre. Qëllimi kryesor i strategjisë është konsolidimi i procesit të decentralizimit, me fokus në zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe transparente. Përmes rritjes së kapaciteteve për menaxhimin e aseteve, digjitalizimit të shërbimeve dhe forcimit të autonomisë financiare, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes vendore. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën

gjithashtu përfshin masa për të siguruar akses më të mirë në shërbime për grupet e cënueshme, duke integruar aspektet e migracionit në zhvillimin lokal, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Një tjetër dokument është **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030** synon zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e jetesës për individët në nevojë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe grupe vulnerabël. Ajo promovon skema financiare të qëndrueshme për fuqizimin dhe integrimin e këtyre individëve përfshirë të huajtë. Strategjia fokusohet në qasjen e barabartë në shërbime sociale dhe zhvillimin e aftësive për integrim në tregun e punës. Masa konkrete mbështesin riintegrimin social-ekonomik, duke lidhur punësimin me promovimin e ndërmarrjeve sociale dhe janë në harmoni me planin për Migracionin dhe Diasporën.

Një rëndësi të vecantë, për vetë faktin se integrimi gjinor vazhdon të mbetet një çështje e nxehte dhe e diskutueshme, paraqet dhe **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030** që është një iniciativë kyçe për promovimin e të drejtave të grave dhe reduktimin e diskriminimit gjinor. E hartuar në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ajo fokusohet në garantimin e të drejtave ekonomike dhe sociale për të gjitha grupet, pa dallim gjinie. Strategjia inkurajon trajtimin e barabartë në shërbime dhe aksesin në teknologji, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Në kuadër të planit të veprimit për Migracionin dhe Diasporën, theksohet rëndësia e barazisë gjinore për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke krijuar një ambient të drejtë për të gjithë individët në shoqëri.

Një aspekt tjetër që prek drejtpërdrejt nivelin lokal është dhe **ligji për Vetëqeverisjen Vendore nr. 139/2015**, së bashku me ndryshimet e **ligjit nr. 38/2019**, ka sjellë një transformim të rëndësishëm në organizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, duke u fokusuar në decentralizimin dhe efikasitetin e administratës publike. Një element thelbësor është angazhimi me diasporën dhe komunitetet e migrantëve, ku bashkitë tani kanë përgjegjësi të qarta për këto grupe. Struktura të posaçme adresojnë shqetësimet e të rikthyerve dhe emigrantëve, ofrojnë asistencë dhe informacion mbi legjislacionin e investimeve, si dhe krijojnë mundësi integrimi, duke forcuar lidhjet midis shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo kontribuon në forcimin e komuniteteve dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë.

Një ligj që prek drejtpërdrejt kategorinë e të huajve në Shqipëri është **"Ligji për Të Huajt" nr 79 / 2021** që është një dokument i rëndësishëm që rregullon mënyrën se si individët e huaj hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga vendi. Ai përfshin aspekte kyçe si lëshimi i vizave dhe lejeve të qëndrimit, duke mbështetur parime themelore si interesi më i mirë i fëmijëve, uniteti familjar

dhe mosdiskriminimi. Ky ligj zbatohet për të huajt që vijnë në Shqipëri për arsye punësimi, studimi ose qëndrimi, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe ato të autoriteteve përkatëse. Me avancimin e procesit të dixhitalizimit, aplikimet për vizat dhe lejet e qëndrimit tani janë bërë më të thjeshta dhe më të aksesueshme, pasi mund të realizohen online. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ata që hasin vështirësi për shkak të mungesës së misionëve diplomatike në disa vende. Gjithashtu, ligji përfshin nisma për integrimin e migrantëve, duke ofruar shërbime dhe programe arsimore që ndihmojnë ata në orientimin në sistemin institucional shqiptar. Kjo qasje e integruar jo vetëm që përmirëson aksesin në shërbime thelbësore, por gjithashtu nxit një integrim të suksesshëm të të huajve në shoqërinë shqiptare. Duke siguruar mbështetje dhe burime, ligji respekton të drejtat e njeriut dhe kontribuon në krijimin e një ambienti më mikpritës për të gjithë ata që zgjedhin Shqipërinë si vend të tyre të ri.

PLANET VENDORE TË BASHKISË FIER

Në 10 vjecarin e reformës territoriale, bashkitë tashmë kanë konsoliduar profilet e tyre territoriale, financiare dhe administrative. Përgjatë kësaj periudhe, fenomene të shumta sociale kanë konturuar shoqërinë shqiptare. Një nga fenomenet më të përfolura dhe më evidente kanë qënë lëvizjet migratore brenda dhe jashtë vendit. Ligji i reformës administrative territoriale tashmë ka shtuar edhe shërbimet që bashkitë do të ofrojnë për qytetaret, duke plotësuar kështu kornizën dhe strukturat organizative menaxheriale.

Veprimtaria e Bashkisë Fier vjen e plotësohet gjithnjë e më tepër me shërbime efektive dhe cilësore për banorët e saj. Për arritjen e efikasitetit financiar, menaxherial apo të politikave, për komunitetin e saj, bashkia harton një sërë masash dhe objektivash për ti realizuar brenda një harku kohor. Ndarja e masave dhe objektivave sipas fushave të veprimit, në përputhje me vizionin e bashkisë, krijon një kornizë më të qartë të detyrave të saj, duke nxjerrë në pah nevojat për të ardhmen.

Dokumenti bazë i zhvillimit të Bashkisë Fier është *Strategjia e Zhvillimit të Territorit* miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5 Datë 29.12.2016, i cili ndërlidh në mënyrë të pashmangshme të gjithë sektorët. Analiza e kësaj strategjie identifikon dhe jep një orientim të qartë për potencialet dhe sfidat e zhvillimit të Bashkisë së Fierit, duke përcaktuar prioritetet dhe masat e nevojshme për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të përparuar për të gjithë komunitetin. Kjo strategji integron aspekte të zhvillimit ekonomik, burime natyrore, mjedisore, mbrojtjes së mjedisit, dhe përmirësimit të kushteve sociale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe inkluziv për të gjithë komunitetin. Kështu rezervat e mëdha naftëmbajtëse në zonën e Patos-Marinzës, me një potencial të konsiderueshëm për zhvillim ekonomik në sektorin e naftës dhe gazit natyror ka ndikuar në rritjen e Vlerës së Shtuar Bruto në nivel vendi¹. Megjithatë, është e rëndësishme që Fieri të diversifikojë burimet e energjisë dhe të përdorë potencialet e tjera të energjisë së rinovueshme, si dielli, era, dhe energjia gjeotermale, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Aspekti social kulturor i bashkisë, mbart si traditat, zakonet, veshjet popullore, këngët dhe vallet, krijojnë një ofertë të pasur për turizmin kulturor². Kjo jo vetëm që promovon identitetin

¹ <https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/2.-Dokumenti-i-Strategjise-Fier-29.12.2016.pdf>

² <https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/2.-Dokumenti-i-Strategjise-Fier-29.12.2016.pdf>

e qytetit, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sektorit turistik dhe në diversifikimin e burimeve të ardhurash për komunitetin vendas. Por nuk ka një aktivitet të mbushur kulturor, përveç herë pas here në Teatrin Bylis dhe Galerinë e Artit Fier, apo ditët me diasporën që organizohet në Greqi. Kjo tregon përpjekjet e bashkisë për ruajtjen e lidhjeve dhe promovimin e zonës në rrëthet e diasporës, gjë e cila demonstron edhe me prezencën e një anëtarit të diasporës në Këshillin Bashkiak, komponent ky që premtonte për intensifikim dhe zhvillim të diasporës në vend.

Plani Lokal i Strehimit Social 2023-2028 për Bashkinë Fier përfshin një gamë të gjerë programesh për të siguruar strehimin dhe përmirësuar kushtet e banimit për komunitetin lokal. Ai identifikon dhe prioritetizojnë grupet më të nevojshme, si emigrantët e rikthyer, duke u përpjekur që 60% e tyre të kenë akses në strehim të përballueshëm³. Kjo përfshin programet e ndryshme të strehimit si banesa sociale me qira, përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese, banesa me kosto të ulët, zhvillimi i zonave për strehim, banesa të përkohshme, dhe banesa të specializuara. Kjo mund të realizohet përmes përfshirjes së tyre në programet për përfitim të subvencioneve për qera ose banesa sociale, në masat konkrete të përcaktuara në këtë plan. Në lidhje me burimet financiare për këto programe, është theksuar se të ardhurat e bashkisë sigurohen përmes të ardhurave të veta nga taksa dhe tatimet, si dhe nga buxheti i shtetit. Realizimi i planit lokal për strehimin social mund të shërbejë si kusht për përfitimin e fondeve shtetërore dhe donator për këtë qëllim, sepse bashkia ka sfida në kapacitetin për ndërtimin e banesave sociale apo rikonstruktimin e banesave të tjera shtetërore. Një mundësi për përfshirjen e diasporës në këto programe është nëpërmjet investimeve në banesa sociale apo duke ofruar mundësi për subvencionim të qerajeve për komunitetet e rikthyer.

Relacioni i Planit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026 për tre vitet e ardhshme në Bashkinë Fier, ka si qëllim kryesor është rritja e të ardhurave, shërbimeve, aksesit dhe cilësisë së jetës nga qyteti deri në gjithë territorin e bashkisë. Fokusi i orientimit të bashkisë në këtë periudhë është bazuar në disa faktorë kyç:

- a) Forcimi i kapaciteteve administrative dhe zgjerimi i bazës së taksapaguesve: Bashkia synon të forcojë menaxhimin e të ardhurave dhe të zgjerojë bazën e taksapaguesve për të rritur nivelin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
- b) Lehtësimi i procedurave për bizneset dhe qytetarët: Një fokus i rëndësishëm është në

³ Bashkia. Plani I Strehimit Social. fq.40.

lehtësimin e procedurave administrative për bizneset dhe qytetarët, që do të ndihmojë në uljen e hendekut tatimor.

- e) Ecuria e realizimit të të ardhurave: Bashkia do të monitorojë ecurinë e të ardhurave dhe do të analizojë faktorët që ndikojnë në rritjen ose uljen e arkëtimeve. Kjo përfshin identifikimin dhe luftën kundër evazionit fiskal dhe ekonomisë informale.

Këto shtylla do të zhvillohën në masën e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit dhe gjithpërfshirjen, me support të gjerë.

PROFILI I BASHKISË FIER

Bashkia e Fierit, vendosur në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe me një pozicion gjeografik dhe strategjik të favorshëm, është një nga qendrat më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social në vendit. Territori i bashkisë Fier përshkohet nga dy lumenj të rëndësishëm, Seman dhe Vjosë, me sipërfaqe të mbrojtura natyrore, për shkak të pasurive që përmbajnë. Fieri ndodhet në qendër të rrjetit kombëtar rrugor dhe hekurudhor, duke i premtuar prosperitet ekonomik të zonës, veçanërisht bashkisë. Bashkia Fier përbëhet nga 13 njësi administrative (4 njësi urbane + 9 njësi rurale), të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër, të shtuara pas reformës administrative të vitit 2014, duke e zgjeruar territorin deri në 620 km² si dhe një popullsi prej 209275 banorësh. Kjo bashki kufizohet në veri me bashkinë Divjakë, në lindje me bashkitë Patos dhe Roskovec, ndërsa në jug me bashkinë Vlorë. Përbën qendrën e dytë më të rëndësishme pas Tiranës, për sa i përket zhvillimit dhe territorit. Territori i tij është i pasur me burime natyrore të cilat janë një avantazh për zhvillimin e zonës, duke përfshirë tokën bujqësore dhe pjellore të Myzeqesës. Disa nga pikat kyçe të rëndësishme të Bashkisë së Fierit:

Pozicioni gjeografik dhe strategjik: Fieri ndodhet në ultësirën perëndimore të Shqipërisë, një pozicion që e bën atë një qendër të rëndësishme në lidhje me rrjetin rrugor dhe hekurudhor të vendit. Kjo e favorizon në aspektin e transportit dhe lidhjes me qytete të tjera të rëndësishme.

Potenciali industrial dhe natyror: Fieri është një nga qytetet me potencial industrial më të madh në Shqipëri, me një fokus të veçantë në sektorin e hidrokarbureve. Prania e burimeve të naftës dhe gazit natyror, si dhe infrastruktura e zhvilluar rrugore dhe hekurudhore, e bëjnë atë një destinacion tërheqës për investime industriale. Bashkia Fier përmban rajonin më të madh naftëmbajtës dhe të hidrokarbureve në Shqipëri, dhe më të madhin në Europë. Potenciali industrial i Fierit, për energjinë, gaz natyror, bitum, naftë etj është i pacmueshëm për vendin, por që sigurisht kërkon fuqizim dhe mirmbajtje.

Rëndësia administrative dhe ekonomike: Bashkia e Fierit është e përbërë nga një numër i konsiderueshëm i njësive administrative, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale. Kjo e bën atë një qendër administrative dhe ekonomike për zonën rrethuese, duke ofruar shërbime dhe



mundësi zhvillimi për popullsinë vendase.

Rëndësia e bujqësisë: Në të njëjtën kohë, terreni fushor dhe bujqësia e pasur e kësaj zone ofrojnë një potencial të madh për zhvillim bujqësor dhe agroturistik. Me 5.7% të tokës së saj bujqësore dhe një mjedis të përshtatshëm për bujqësinë, Fieri ka mundësinë të zhvillojë sektorin bujqësor dhe të krijojë burime të reja të ardhurash për komunitetin vendas. Duke u shtrirë në Myzeqe, konsiderohet dhe si “hambari” I Shqipërisë.

Përkundër të gjitha këtyre potencialeve dhe mundësive për zhvillim, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet nevoja për përmirësimin e infrastrukturës, menaxhimit të burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme, si dhe zhvillimin e politikave të mirëmbajtjes së mjedisit për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë për qytetin dhe për të gjithë rajonin.

Bashkia e Fierit ka një pozicion strategjik të rëndësishëm në lidhje me gazifikimin e mundshëm, veçanërisht pas vënies në zbatim të Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP). Korridori VIII është një korridor që lidhë Ballkanin Perëndimor me Evropën Qendrore dhe Lindore. Kjo rrugë është e rëndësishme për transportin e mallrave dhe personave në nivel ndërkombëtar, duke lidhur portet detare të Shqipërisë me vendet tjera të Ballkanit dhe me Evropën. Korridori Blu, ose Autostrada Adriatik-Joniane, është një tjetër rrugë e rëndësishme në Shqipëri që lidhë Durrësin në bregdetin Adriatik me Sarandën në jug të vendit. Kjo rrugë është e rëndësishme për zhvillimin e turizmit bregdetar dhe për lidhjen e qyteteve kryesore dhe zonave industriale në vend, duke shtuar mundësit për të zhvilluar sektorin e tij të transportit dhe infrastrukturës.

Në anën tjetër, qyteti gjithashtu ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe sociale, e cila mund të përfaqësohet në turizmin kulturor. Traditat, zakonet, këngët, vallëzimet dhe kuzhina e mrekullueshme janë vlera të cilat mund të shndërrohen në një atraksion për turistët dhe të kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së turizmit.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe që të përfitojnë të gjithë qytetarët, është e rëndësishme që koncepti i zhvillimit të përfshijë edhe mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual. Kjo do të siguronte që të gjithë banorët e Fierit të përfitojnë nga zhvillimi i qytetit në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme, duke garantuar një të ardhme të frytshme dhe të shëndetshme për brezat e ardhshëm, me potencial për rikthimin e emigrantëve si dhe identifikimin dhe forcimin e diasporës në vend.

Profili Demografik

Popullsia e Bashkisë Fier për vitin 2023 është 209275 banorë, sipas Regjistrit të Gjendjes Civile Fier. Për qytetin janë 96329 banorë rreth 46% dhe për fshatrat 112946 banorë. Pas qytetit të

Fierit njësit më të mëdha administrative janë Cakran dhe Levanit të cilat janë dy njësitë ku është përqendruar pjesa më e madhe e popullatës së Bashkisë. Për vitin 2022 sipas të dhënave të bashkisë, për raportin gjinor vërehet se: Vetëm në bashkinë Fier e 4 zonat e saj, ka dominancë të numrit të banorëve femra me 323 më shumë se meshkuj, por në nivel total kemi dominancë të lehtë të numrit të gjinisë mashkullore.

Nëse krahasojmë dy vitet e fundit, 2022 dhe 2023, lindjet në Bashkinë e Fierit janë ulur me 25 banorë ndërsa vdekjet janë ulur me 75 banorë. Bashkia Fier ka shtesë natyrore negative në vitin 2020 po kështu edhe qarku Fier i cili është gjithashtu në shtesë natyrore negative. Sipas vjetarit statistikor rajonal, 2021 migrimi i brendshëm neto për Bashkinë Fier është 503 banorë, ku në rang qarku shkalla e migrimit neto për 1000 banorë është -1402.

Nga të dhënat e administruara në Bashki, vërehet papunësia që është në nivele të larta, po ashtu niveli i ulët i vetëpunësimit apo e mundësive për gjenerimin e të ardhurave, bëjnë që problematikat e varfërisë të jenë mjaft të ndjeshme. Një tregues i kësaj problematike është edhe skema e Ndihmës Ekonomike (NE). Për vitin 2023, rreth 450 familje janë përfituese të N.E. Arsimitimi i popullsisë së rajonit të Fierit, është në nivele të larta. Ajo që vërehet është fenomeni i braktisjes së arsimit më tepër te grupet në nevojë dhe të pa favorizuara, e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në nxitjen e fenomenit të migrimit.



PERSPEKTIVA GJINORE

Përkatësia Gjinore në Çështjet e Migracionit dhe Diasporës

Perspektiva gjinore në çështjen e migracionit dhe diasporës përfaqëson një qasje të rëndësishme që eksploron sesi rolet tradicionale gjinore, normat kulturore dhe struktura sociale ndikojnë në përvojat dhe vendimet e individëve që migrojnë. Migracioni nuk është një përvojë uniforme; ajo ndryshon në mënyrë të theksuar sipas gjinisë, duke formuar ndryshe sfidat dhe mundësitë për burrat, gratë dhe individët me identitete gjinore të ndryshme.

Historikisht, burrat janë parë si kryesorët që marrin rolin e migrantit, duke u larguar për të kërkuar mundësi ekonomike dhe për të mbështetur financiarisht familjet e tyre. Në këtë kontekst, gratë kanë luajtur rolin e kujdestarëve të familjes, që mbeten pas në vendin e origjinës. Megjithatë, ky model ka evoluar ndjeshëm. Sot, një numër i madh i grave marrin pjesë në proceset migratore, shpesh duke u bërë kryefamiljare dhe duke përmbushur një sërë përgjegjësisish që më parë mund të ishin rezervuar për burrat. Pavarësisht nga kjo rritje e pjesëmarrjes së grave në migracion, përvoja e tyre shpesh mbetet e karakterizuar nga pabarazia dhe diskriminimi. Gratë migrante janë më të prekshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimeve seksuale, shfrytëzimit në tregun e punës dhe dhunës fizike e psikologjike. Në shumë raste, ato përballen me një mungesë të qasjes në shërbime shëndetësore, edukative dhe mbrojtje ligjore, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të ligjshëm ose frikës nga abuzimeve. Nga ana tjetër, burrat përballen me presione të tjera, shpesh të ndërlidhura me pritshmëritë tradicionale që lidhen me rolin e tyre si "mbajtësit e familjes". Ata mund të përballen me sfida të rënda në tregun e punës, shpesh duke u përfshirë në sektorë me rrezik të lartë dhe paga të ulëta. Për burrat, migracioni mund të nënkuptojë edhe izolim shoqëror dhe mungesë të mbështetjes emocionale, pasi normat gjinore shpesh nuk lejojnë hapjen e tyre për ndihmë. Kur gratë migrojnë, një tjetër aspekt i rëndësishëm është roli që luajnë si faktor ndryshimi në familjet dhe komunitetet e tyre. Shpesh, ato përjetojnë transformim në strukturat gjinore, duke marrë më shumë autonomi dhe fuqi vendimmarrëse në familje dhe duke ndikuar në ndryshimin e normave tradicionale në shoqërinë e origjinës së tyre por edhe në përplasjen që mund të ndeshen për shkak se ndryshimet në një kulturë nuk janë të lehta për tu përballur.

Në diasporë, gjinia luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të individëve. Gratë shpesh kontribuojnë në ekonomitë e vendeve pritëse në sektorë të nënvlerësuar si puna në shtëpi, kujdesi dhe shërbimet, ndërsa burrat në sektorët e vështirë ose punët e rënda ndërtim, transport, riciklim, apo lloje të tjera punësh me kualifikim të ulët

ose bazë. Megjithatë, këto punë janë shpesh të padukshme dhe të nënvlerësuar nga shoqëria pritëse. Diaspora mund të ofrojë një hapësirë për ndërtimin e solidaritetit midis grave, si edhe midis burrave, ashtu sikurse edhe midis dy gjinive me njëra tjetrën, duke krijuar rrjete mbështetjeje për të ndihmuar njëra-tjetrën të përballen me sfidat e përditshme të jetës së migrantëve.

Në këtë kuadër, perspektiva gjinore zbulon sesi gratë dhe burrat e prekur nga migracioni përjetojnë në mënyra të ndryshme problemet dhe sfidat që lindin nga vendimi për të lëvizur. Kjo qasje e thellë dhe gjithëpërfshirëse i fton profesionistët dhe politikët publike të përqendrohen në njohjen e nevojave dhe përvojave unike të individëve, duke e bërë kështu procesin e hartimit të politikave më të ndjeshëm ndaj gjinisë. Në këtë kontekst, punonjësit socialë luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave specifike që hasin grupet e ndryshme, duke ofruar një mbështetje të personalizuar dhe duke promovuar zgjidhje që respektojnë diversitetin e përvojave njerëzore. Politikët migratore gjithashtu duhet të jenë të ndjeshëm ndaj këtyre dinamikave, duke u siguruar që çdo individ, pavarësisht nga gjinia, të ketë akses në mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme. Kjo do të thotë që strategjitë e migracionit duhet të përfshijnë aspekte të ndryshme, si mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi, si dhe promovimi i integritetit dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional.

Bashkia, si institucioni më afërt me qytetarët, ka një rol kyç në procesin e integritetit dhe mbështetjes së individëve që kthehen ose migrojnë në një zonë të re. Ajo shërben si pika e parë e kontaktit për shumë njerëz që kanë nevojë për informacion rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre si qytetarë, duke ofruar shërbime dhe orientim të domosdoshëm për të kaluar nëpër procedurat administrative dhe sociale. Një plan veprimi për migracionin dhe diasporën është mëse i nevojshëm për të adresuar nevojat specifike të grupëve të ndryshëm brenda shoqërisë. Kur flasim për këtë plan, është e rëndësishme të kemi parasysh dhe perspektivën gjinore, pasi burrat dhe gratë përballen me sfida dhe mundësi të ndryshme në kontekstin e migracionit. Kjo qasje gjinore në menaxhimin e migracionit është thelbësore për të siguruar që nevojat dhe përvojat e të gjithë individëve të merren parasysh. Kjo do të thotë që bashkia duhet të angazhohet në krijimin e politikave dhe programeve që jo vetëm që mbështesin integritetin e migrantëve, por gjithashtu promovojnë barazinë gjinore. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve, aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin dhe bashkëjetesën, si dhe informimin rreth të drejtave ligjore dhe mundësive që ekzistojnë për të dyja gjinive. Një komunitet i integruar dhe i barabartë është një komunitet më i fortë dhe më rezistent, në të cilin çdo individ ka mundësinë për t'u zhvilluar dhe kontribuar në mënyrë të barabartë.

ANALIZA PESTEL

Grupi i ekspertëve të Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Fier për periudhën 2025-2030 përcaktoi zhvillimin dhe përdorimin e analizës PESTEL si një tërësi e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të cilët kornizojnë dhe përcaktojnë në nivel makro, zhvillimin dhe ecimin e një mjedisi të caktuar. Kjo analizë mer në shqyrtim faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, mjedisorë dhe ligjorë në mjedisin e jashtëm. Në realitetin e bashkisë Fier, nisur nga analiza e situatës së faktit, potenciali ekonomik, njerëzor, turistik, vizionit të Bashkisë Fier në vecanti por dhe politikave qendrore në çështjet e diasporës dhe migracionit, elementët me rëndësi në drejtim të përmirësimit të situatës së përgjithshme sipas analizës PESTEL do të përfshijmë:

Tabela 1: Analiza PESTEL

FAKTORËT	Fuqia e ndikimit në zhvillimin e bashkisë	Parashikimi i drejtim të ndikimit të faktorëve
FAKTORËT POLITIK		
Stabiliteti Politik	3	↑
Shpërndarja strukturore e fondeve të BE	2	↑
Bashkëpunimi ndërkombëtar	1	↑
Mbështetja për zhvillimin rajonal	1	↑
Taksat Vendore	2	↑
Niveli i decentralizimit	1	→
Rregulloret mjedisore	1	→
Kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel vendor	3	↑
Zhvillimi i partneritetit publik privat	3	↑
FAKTORËT EKONOMIKË		
Gjendja e ekonomisë	2	↑
Dinamika e rritjes ekonomike	1	↑
Gjendja e financave publike	1	↑
Zhvillimi i industrisë së turizmit	2	↑
Tendencat ekonomike të brendshme	3	↑
Ndikimi dhe niveli i investimeve të huaja	1	↑
Vendndodhja gjeografike	3	↑
Konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale	1	→
Cilësia e politikës ekonomike qendrore	3	↑
Niveli mesatar i të ardhurave	2	↑

Kostot e punës	2	↑
Shkalla e papunësisë	3	↓

FAKTORËT SOCIAL-KULTURORË

Roli i burrave dhe grave në shoqëri	2	↑
Emigracioni i punëtorëve të kualifikuar	3	↓
Imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar	3	↓
Ndërgjegjësimi ekologjik	2	↑
Pabarazitë sociale	2	↓
Zhvillimi i kapitalit njerëzor	3	↑
Lëvizshmëria e punëtorëve	3	↑
Tendencat e stilit të jetesës	2	→
Nivelet e përgjithshme të aspiratës së njerëzve	1	→
Zhvillimi i Organizatave Joqeveritare	1	→
Fondet për kujdesin shëndetësor dhe social	1	↑
Shkalla e rritjes së popullsisë	2	↑
Plakja e popullsisë	3	↓
Identiteti lokal	2	↑

FAKTORËT TEKNOLOGJIKË

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit (teknik).	3	↑
Fondet për projektet e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit	1	→
Automatizimi	2	↑
Zhvillimi i mediave sociale	3	↑
Zhvillimi i inovacionit	1	↑
Zhvillimet e fundit teknologjike	2	↑
Akses në teknologjitë moderne	3	↑
Zhvillimi i tele-ëork	1	↑

*Legjenda e Tabelës

Fuqia e ndikimit:

- ❖ 3-e lartë;
- ❖ 2-mesatare;
- ❖ 1-e ulët

Parashikimi i drejtimit:

- ❖ pozitive ↑;
- ❖ ska ndryshim →;
- ❖ negative ↓

Nga analiza e kryer e faktorëve politik në tërësi, për Bashkinë Fier, elementët me ndikimin më të lart janë stabiliteti politik, kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel vendor, dhe partneriteti publik privat të ndjekur nga fondet e BE dhe taksat vendore me nivelin mesatar të ndikimit, dhe më pak janë masat apo rregulloret mjedisore të cilat edhe efektet në zhvillim parashikohen

të jenë neutrale. Ndërsa decentralizimi, mbeshetja dhe zhvillimi rajonal ndikimin e kanë të ulët aktualisht por efektshmërinë e kanë pozitive. Ajo që del në pah është mungesa e aplikimeve dhe projekteve në këtë fushë, mungesë ofrtash dhe mungesë ekspertize sidomos për aplikimet e fondeve të BE. Por duhet theksuar se kjo është një drejtim i ri për Bashkinë në vetvete, në kutimin e dedikimit drejt këtij sektori. Elementët më me ndikim paraqiten si më poshtë:

Stabilitet Politik: i rëndësishëm në sigurimin e vazhdimësisë dhe stabilitetit menaxherial. Vazhdimi dhe eksperiencia do të garantojnë efektivitetin e masave dhe punëve të ndërmarra. Fonde nga BE-Programet për zhvillim të qëndrueshëm të BE janë shumë efektive për suportin që ofrojnë pushtetit lokal, në kushtet edhe të vështirësive financiare, apo mënyrës së implementimit. Programe të tilla janë të shtrira në kohë dhe me kapitale të konsiderueshme për të siguruar një përmirësim të dukshëm në një sektor. Këto fonde syhohen nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme të institucioneve lokale në nivel ndërkombëtar

Taksat Vendore: Problemi që prek zakonisht pushtetin vendor, për shkak të pamundësisë së mbledhjes së tyre por edhe për shkak të tarifave të larta. Në mënyrë që të tërhiqen investime të reja por dhe të huaja është shume e rëndësishme rishikimi i këtyre taksave, duke realizuar një *“diskriminim pozitiv”* pra me të ulëta në fillim për investitorët e rinj të huaj.

Kapacitetet njerëzore: Kapitali njerëzor paraqet një aset të rëndësishëm në hartimin dhe menaxhimin e politikave të ndryshme, ofrimin e shërbimeve për qytetarët, implementimin e programeve specifike, rritjen e performancës së bashkisë dhe institucioneve të saj. Burime njerëzore të kualifikuara, të motivuara dhe me kushte pune të përshatshme, ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorve të tyre.

Faktorët ekonomik: në tërësinë e tyre kanë ndikim në jetën e një bashkie. Bashkia Fier, nga analiza e situatës ekonomike ka evidentuar si faktor me ndikimin më të madh turizmin, pozitën gjeografike, dinamikën e rritjes ekonomike, investimet, cilësia e politikës qendrore në nivel vendor. Këto element shprehin dominancë por në të gjitha rastet ndikimi i tyre është pozitiv. Për t'u theksuar është dhe norma e papunësisë me ndikim shumë të lart por me efekt negativ, e cila kërkon adresim dhe ndërlidhet me cilësinë e politikave qendrore. Niveli mesatar dhe i ulët përbëhet nga element si konkurrenca me rajonet e tjera, niveli ekonomik në tërësi, kostot e punës, investimet e huaja, financat publike, të ardhurat mesatare, të cilat kanë efekte të ndryshme në ekonominë lokale të bashkisë Fier. Dinamika e rritjes ekonomike është nga elementët më spikatës, pasi kjo bashki ka resurse dhe mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik të orientuar nga ato me potenciale të mëdha si burimet nëntokësore por edhe bujqësore.

Zhvillimi i Turizmit: Në aktualitetin e vendit tonë në tërësi, por edhe lokal turizmi është kthyer në një nga promotorët kryesor potencial të zhvillimit ekonomik dhe kulturor. Lëvizjet, hyrje daljet e turistëve të ndryshëm, ndikojnë direkt në ekonomi, ata sjellin me vete dhe pjesë të kulturës dhe traditave të tyre, të cilat shpesh herë korporohen në realitetin vendas lokal. Turizmi përbën një degë të ekonomisë që gjithmonë do të jetë në ndryshim dhe në zhvillim, prandaj shihet nevoja e fukusit të shtuar në këtë aspekt.

Dinamika e Rritjes Ekonomike: Falë zhvillimeve teknologjike por jo vetëm, ekonomia e një rajoni, mund të mari dinamika të ndryshme në të njëjtën kohë dhe për një periudhë më të shpejt, duke ju përshtatur ritmeve të jetes dhe zhvillimeve ndërkombëtare.

Investimet e huaja: Fasoneri, nxjerje e naftës, etj janë drejtimet në të cilat investimet e huaj janë më tepër të fokusuara. Nën shembullin e tyre bëhet e nevojshme zgjerimi edhe në sektorë të tjerë të prodhimit apo shërbimit, si edhe përmirësimi i këtyre që janë.

Pozita Gjeografike: Pozita gjeografike është nga elementët më të rëndësishëm në bashkinë e Fierit, duke e pozicionuar në një kordinatë tepër të favorshme andaj dhe njihet si hambar I vendit. Kjo është një favor I madh për këtë bashki duke I siguruara dhe garantuar mirqënie ekonomike apo burime të sigurta.

Cilësia e Politikës Qendrore: Pushteti lokal ka një varësi të konsiderushme nga pushteti qendror, e cila ka të bëjë jo vetëm në aspektin financiar, por më së shumti për politikat e hartuara dhe orientuar drejt pushtetit lokal, si dhe fokusi që mer. Është shumë e rëndësishme që politikat për zbatim dhe implementim nga pushteti lokal të kenë koherencën dhe cilësinë e nevojshme, gjë e cila reflektohet në mirëqeverisje dhe ndikon drejtpërdrejt te qytetarët.

Papunësia: Normat e papunësisë, janë tregues real i zhvillimit të një rajoni, mirqënies ekonomike dhe sociale të individit, efektivitetit të politikave qendrore dhe lokale. Kërkohet një vëmendje e shtuar, për uljen e normave të papunësisë në zonën e Fierit.

Një numër i konsiderueshëm **faktorësh social-kulturorë** vlerësohen me ndikim të madh për zhvillimin e Bashkisë Fier si, emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar, zhvillimi i kapitalit njerëzor, lëvizshmëria e punëtorëve dhe plakja e popullsisë. Roli i këtyre faktorve parashikohet se ka ndikim pozitiv për barazinë gjinore, zhvillimin personal dhe profesional por edhe cilësinë e jetesës së komunitetit. Ndërsa emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i puntorëve të pakualifikuar dhe plakja e popullsisë vlerësohet se do të kenë efekt negativ edhe në të ardhmen. Faktorët social -kulturor në tërësinë e tyre kanë një ndikim të lart për orientimin dhe zhvillimin e një rajoni, pasi trajtojnë të gjithë fushat e

jetës. Gjithashtu, Bashkia ka nevojë për përditësim të informacionit me shifra të sakta për emigrimin e puntorëve të kualifikuar, imigrimin e punëtorëve të pakualifikuar, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe lëvizshmërinë e punëtorëve për të adresuar nevojat dhe shqetësimet kryesore jo vetëm për imigrantët por edhe për të huajt që jetojnë në këtë zonë në mënyrë që të mundësohet aksesimi në shërbime shëndetësore, arsim, apo tregun e punës.

Emigrimi i Punëtorëve: Lëvizja e lirë e punëtorve dhe individit të kualifikuar, tashmë është një çështje globale. Në rastin e këtyrë flukseve dhe lëvizjeve migratore (që sjellin emigrantë nga vende të tjera) është e rëndësishme hartimi i politikave dhe programeve për mbajtjen e tyre në vend, përmirësimin e cilësisë së jetesë, sigurimin e kushteve më të mira të punës dhe vlerësimit. Në të njëjtën kohë dhe paralelisht duhet të zhvillohen mekanizma për integrimin e migrantëve, të rikthyerve apo përthithjen e specialistëve të kualifikuar.

Zhvillim i Kapitalit njerëzor: Zhvillimi i kapitalit njerëzor në aspektin social dhe kulturor, konsiston në angazhimin e elementëve të rinjë, kreativë me background të lakmueshëm në ofrimin e shërbimeve social kulturore me cilësi dhe efikasitet, Punonjësit në pozicione social kulturore duhet të jene shume të përfshire dhe të angazhuar ne aktivitete inovatore dhe gjithpërfshirëse.

Kreativiteti rajonal, identiteti lokal: Kjo vecon një krahinë nga një tjetër, duke synuar kështu përthithjen e disaporës lokale, apo dhe orientimin e migrantëve të kthyer drejt ideve dhe zhvillimeve potenciale të rajonit. OJF-Kombëtare dhe Ndërkombëtare shpesh shërbejnë si pasqyra e pushtetit lokal, pasi nëpërmjet punës së tyre në terren por jo vetëm, dalin në pah mjaft aspekte që kanë nevojë për përmirësim dhe suport të shtuar. Por këto organizata duhet të shifen si partnerë të ngusht të pushtetit dhe organeve legjislativë, në mënyrë që nëpërjet tyre të adresohen dhe zgjidhen mjaft problematika sociale dhe kulturore më së shumti.

Fonde për kujdesin shëndetësor social: Janë ajo pjesë e fondeve të bashkive e cila nuk përdoret për qëllimin e akorduar, por mbulohen mangësira të tjera të nevojshme. Si e tillë nëse bashkitë bashkpëunojnë me OJF apo diasporën mund të adresohen çështje të rëndësishme, duke liruar fondin e kujdesit social.

Plakja e popullsisë: Edhe pse ofrohen bonuset e bebeve për familjet e reja, apo programe strehimi me kredi të lehtësuara, kjo është një çështje që buron nga fenomeni i migracionit më së shumti. Në këtë rast duhet të bëhen ndërhyrje në programe kthimi dhe riintegrimi, sigurimin e masave lehtësuese për bizneset e reja të të rikthyerve.

Barriera kulturore: Mund të vërehet në qasjet midis diasporës dhe popullsisë a po

institucioneve në mënyrën e adresimit dhe zgjidhjes së problemeve të ndryshme llojin e aktiviteteve kulturore, sociale, mënyrën e implementimit dhe kuptimit të politikave sociale në nivel vendor , si dhe sjell pengesa në kohë dhe cilësinë e shëbimeve.

Inovacioni dhe teknologjia kanë kapur vëmëndjen e politikave lokale dhe qendrore për zhvillim. Fokusi primar është në zhvillimin e mediave sociale, pasi ka ndikim më të lartë dhe aksesohet lehtësisht. Për rrjedhim ka efekt pozitiv të menjëhershëm në shpërndarjen e informacionit dhe mundëson komunikimin e shpejtë dhe në kohë reale me migrantët dhe diasporën. Aksesit në teknologji, dikon jetën e përditshme dhe vështirëson disa aspekte jetësore, nëse nuk i akseson dot. Faktorët me efekt mesatar janë zhvillimi i infrastrukturës, automatizimi, aksesit në teknologjinë moderne dhe zhvillimi i tele-çorë, ndikimi i të cilave parashikohet pozitiv por ka mungesë të theksuar të infrastrukturës dhe duhet përditësim me zhvillimet teknologjike.

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit publik: Infrastruktura rrugore dhe komunikacioni sjellin padiskutim zhvillim dhe kushte të përmirësuara jetëse, e cila dëshmohej në mënyrë mirë aktualisht në vend. Infrastruktura e zhvilluar, ndikon në turizëm, sektorët e bujqësisë që kanë nevojë për komunikacion në mënyrë që të shesin produktet e tyre, hapjen e bizneseve të reja etj.

Zhvillim i Mediave Sociale: sot janë aktualiteti dhe pasqyra e punëve dhe angazhimeve. Mediat sociale kanë pothuajse rol të pazëvendësueshëm si pozitiv edhe negativ. Duke qënë promotorë të rëndësishëm është e nevojshme fuqizimi dhe orientimi i duhuri i tyre, në mënyrë që të lehtësojnë dhe përmirësojnë situatën.

Inovacioni: Bashkitë duhet të priren drejt inovacionit dhe të sigurojnë ecjen sipas këtyre zhvillimeve, sepse kështu ulen kostot dhe rritet cilësia dhe efikasiteti.


Faktorët Mjedisor dhe Ligji: në lidhje me dy fushat e tjera (*Environment and Legal, Law*), fokusi do të jetë drejt politikave miqësore me mjedisin, anagzhimin dhe orientimin drejt politikave gjinore dhe elementëve gjinore, duke garantuar pjesmarrje dhe përfshirje të barabartë, fuqizimin e gruas vendase dhe të diasporës.

QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën është të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe të koordinojë çështjet e migracionit dhe diasporës, duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal. Bashkia Fier synon të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, të jetë në shërbim të qytetarëve cdo ditë pavarësisht nga vendndodhja e tyre, dhe punon për të nxitur përfshirjen dhe integrimin e tyre me të drejta të plota dhe të barabarta.

VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Vizioni ynë është të fuqizojmë këta individë dhe të forcojmë lidhjet me diasporën, duke krijuar një rrjet mbështetjeje dhe bashkëpunimi. Duke ofruar mundësi për edukim dhe trajnim, ne ndihmojmë çdo migrant të zhvillojë aftësitë e tij dhe të kontribuojë në komunitetet e tyre duke krijuar një efekt pozitiv në vendet e origjinës dhe në ato pritëse, duke rritur nivelin e integritit dhe mirëqenies. Përmes iniciativave që bashkojnë migrantët me diasporën, promovojmë investimet dhe zhvillimin ekonomik. Një diasporë e angazhuar është një burim i çmuar për inovacion dhe zhvillim, dhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë potencial për të ndihmuar në transformimin e shoqërisë për një të ardhme ku migrantët dhe diaspora të integrohen plotësisht.



BASHKIA FIER NË 2030

***“FUQIZON MIGRANTËT, AFRON
DIASPORËN PËR ZHVILLIM &
INTEGRIM”***

OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR FIER

Bashkia Fier do i realizojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara në 3 fusha veprimi si më poshtë:

Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Fier

Fusha A. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.	
Objektivat	A.1 Rritja e efikasitetit dhe organizimit të strukturave vendore për menaxhimin e diasporës dhe migracionit.
	A.2 Përmirësim i vazhdueshëm profesional dhe zhvillim i aftësive të specialistëve në njësitë vendore që merren me çështjet e migracionit dhe diasporës.
	A.3 Ndërtimi i partneriteteve funksionale dhe efektive me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.
Fusha B. Shërbimet sociale publike me baze komunitare.	
Objektivat	B.1 Ndërgjegjësimi dhe informimi i vazhdueshëm mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore.
	B.2 Ofrimi i shërbimeve sociale për mbështetjen e përfshirjes dhe riintegrit të migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës.
Fusha C. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit local.	
Objektivat	C.1 Identifikimi dhe shpërndarja e nevojave të komunitetit vendor të diaspora dhe migrantët.
	C.2 Ofrimi i mbështetjes për të rritur investimet publike dhe private nga komuniteti i diasporës dhe migrantët e kthyer.

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

FUSHA E VEPRIMIT A

Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit përfshin rritjen e kapaciteteve të institucioneve lokale, koordinimin me institucionet qendrore dhe organizatat ndërkombëtare, dhe krijimin e urave të qëndrueshme të bashkëpunimit me diasporën. Identifikimi i nevojave të veçanta dhe ndërtimi i një infrastrukture efektive për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin janë elemente kyçe për të arritur suksesin në këtë fushë.

Krijimi i bazave të të dhënave për institucionet dhe organizatat e diasporës dhe migracionit është një hap tepër kritik. Këto baza të të dhënave duhet të përmbajnë informacione të rëndësishme për institucionet, organizatat, dhe grupet e interesit që janë të përfshira në çështjet e diasporës dhe migracionit. Këto të dhëna mund të përfshijnë po ashtu dhe kontaktet, përshkrimin e aktiviteteve dhe projekteve, nevojat e tyre specifike, dhe përvojat e mëparshme të bashkëpunimit.

Platformat e dedikuara në faqet zyrtare të institucioneve dhe organizatave mund të jenë një mjet i fuqishëm për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin. Këto platforma duhet të ofrojnë qasje të lehtë dhe të sigurtë për të aksesuar informacionin dhe për të koordinuar veprimtarinë e përbashkët në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar. Në lidhje me krijimin e databazës së institucioneve qendrore dhe organizatave ndërkombëtare me detyra funksionale për çështjet e diasporës dhe migracionit, është e rëndësishme të përcaktohen rrugët e komunikimit për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë periodike. Kjo mund të përfshijë përdorimin e platformave të dedikuara për të raportuar përparësitë, sfidat, dhe nevojat aktuale, si dhe për të ndarë informacionin mbi projekte dhe inisiativa të suksesshme.

Një qasje e integruar dhe e koordinuar midis institucioneve lokale, qendrore dhe organizatave ndërkombëtare është thelbësore për të siguruar që politikat dhe veprimtaritë në fushën e diasporës dhe migracionit janë efektive dhe të përshtatshme për nevojat e komuniteteve të interesuara.

Tabela 3: Fusha e Veprimit A

Fusha e veprimit A.		Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:				
Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.		Identifikimi i nevojave dhe ndërtimi i një infrastrukture efektive për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.				
	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 1.1: Rritja e efikasitetit dhe organizimit të strukturave vendore për menaxhimin e diasporës dhe migracionit.	a) Përcaktimi i detyrave për individët përgjegjës në strukturën e migracionit dhe diasporës.	2025 - 2026	Burimet Njerezore ne bashkepunim me drejtorine perkatese	MB MCPV Organizata	Përshkrimi i punës i aproruar	1 akt
	b) Miratimi i procedurave standarde për menaxhimin e rasteve që lidhen me migrantët dhe diasporën.	2025 - 2026		MB MCPV Organizata	Procedura të aprovuara	1 vendim
	c) Krijimi i materialeve informuese dhe promovuese për strukturën lokale të Migracionit dhe Diasporës.	2025 - 2026	Specialistet per Migracionin dhe Diasporen Specialistet e IT-se	MB MCPV Organizata	Materiale të prodhura	Deri në 5000 kopje
	d) Zhvillimi dhe përmirësimi i bazës së të dhënave për grupet e diasporës dhe emigrantët.	2025 - 2028	Trajnime te vazhdueshme	AKD AKPA Organizata	Databazë e plotë	1-Vlera bazë 0 2-Matet nga 0
Objektivi 1.2: Përmirësim i vazhdueshëm profesional dhe zhvillim i aftësive të specialistëve në	a) Koordinimi i takimeve që synojnë shkëmbimin e përvojave dhe informacionit ndërmjet organizatave publike, private dhe	2025 - 2028		MB Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr i takimeve dhe rezultatet e arritura

njësitë vendore që merren me çështjet e migracionit dhe diasporës.	të shoqërisë civile.					
	b) Përditësim i vazhdueshëm pranë Sekretariatit Teknik të Migracionit mbi aktivitetet e parashikuara të Bashkisë në kontekstin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2030.	2025 - 2028	Specialistët e Diasporës dhe Migracionit	MB	Raportimet	Nr. i raportimeve
	c) Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që përqendrohen në temat e migracionit dhe diasporës.	2025 - 2028	po	MB ASPA Organizata	Kalendari i trajnimeve	Nr. i trajnimeve; Nr. i specialistëve të trajnuar.
	d) Organizimi i sesioneve të trajnimit me departamentet përkatëse në Bashki që merren me çështjet e migracionit dhe diasporës.	2025 - 2028	po	Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr. i takimeve /organizimeve
Objektivi 1.3: Ndërtimi i partneriteteve funksionale dhe efektive me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.	a) Kordinimi dhe organizimi i një tryeze të përbashkët vjetore midis Bashkisë dhe komunitetit të diasporës.	2025 - 2028	Bashki, Komuniteti Diasporës	AKD, MB	Rritja e identifikimit të diasporës	4 takime konsultative
	b) Themelimi i Këshillit Konsultativ të Diasporës dhe Migrantëve për angazhimin e komuniteteve, migrantëve e diasporës.	2025 - 2028	Bashkia,	AKD, MB	Adresimi i ideve të diasporës në politika lokale	Akti i ngritjes së këshillit
	c) Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë dhe organizatave joqeveritare për përfshije në projekte të ndryshme.	2025 - 2026	Bashki, OJF	Organizata	Zbatimi i projekteve në vit (min. 1 në vit).	Nr. i projekteve
	d) Organizimi i aktiviteteve të ndryshme midis Bashkisë dhe OJQ si dhe lancimi i historive inspiruese të suksesit të emigrantëve që janë kthyer në atdhe.	2025 - 2028	Bashki, OJF	Organizata AKD	Njohja me mundësitë e ndryshme, përvoja të reja dhe motivim.	Nr. i panireve të organizuara. Nr. i rasteve të suksesit të prezantuara.

FUSHA E VEPRIMIT B

Shërbimet sociale me bazë komunitare luajnë një rol thelbësor në mbështetjen e migrantëve dhe diasporës, duke u ofruar atyre mbrojtje dhe mbështetje të nevojshme. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare janë një mekanizëm i domosdoshëm për mbështetjen e migrantëve dhe diasporës. Edukimi mbi të drejtat dhe detyrimet, si dhe sigurimi i mbështetjes për integrim dhe rintegrim, janë hapa thelbësorë drejt ndërtimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, ku çdo individ ka mundësinë të kontribuojë dhe të ndjehet i pranuar. Këto shërbime janë krijuar për të përmbushur nevojat specifike të këtyre grupeve, me synimin për të lehtësuar përfshirjen sociale dhe procesin e rintegrimit në komunitet. Shpesh, migrantët përballen me sfida të tilla si mungesa e informacionit dhe paqartësitë ligjore, të cilat vështirësojnë aksesin e tyre në shërbime bazë si shëndetësia, arsimi dhe mbështetja sociale. Publikimi dhe shpërndarja e materialeve informuese do të jetë një proces periodik i bashkisë. Do të realizohen aktivitete të ndryshme për ofrimi i informacionit të qartë dhe të besueshëm si takime periodike me organizata lokale që punojnë me këtë target grup, po ashtu aktivitete për promovimin e të drejtave të grave, fushata informimi 1 javore.

Me synim fuqizimin dhe integrimin e tyre më të mire, bashkia do e ketë fokusin e shtuar në referimin e tyre drejt shërbimeve sociale, punësimit dhe formimit profesional. Shërbimet duhet të ofrojnë ndihmë të plotë në procesin e rintegrimit, përfshirë mundësitë e punësimit, trajnimet profesionale dhe mbështetjen psikologjike. Kjo ndihmon individët të përballen me sfidat që vijnë pas kthimit, si përshtatja me ndryshimet sociale dhe kulturore të vendit të origjinës. Asistence të dedikuara për aksesin e shërbimeve do të kryhet nga specialist i çështjeve gjinore prane bashkisë.

